



Kërko

☒ Të gjitha fjalët ☐ Të paktën një fjalë ☐ Fjalët ekzakt☐ DITA E DYTË E VAKSINIMIT NË SHQIPËRI**POP 5**

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



vendi është vendosur (VIDEO)

1 Spitali i Fierit/ Pronarët e tokave pas takimit me Ramën: Duam çmimin e tregut! Kryeministri na tha që



minimale 40 mijë lekë

2 Përfaqësuesi turk: Spitali në Fier 60-70 mln euro! 20-30% e punonjësve do jenë shqiptar! Rama: Paga



3 60-70 mln euro! Rama: Paga minimale për punëtorët 40 mijë lekë (VIDEO)

Spitali i Fierit/ Përfaqësuesi turk: Na ka porositur Erdogan, fillojmë që nesër punën! Do të kushtojë



hiqer

Aktualitet

E spiunuan qytetarët, Presidenti i klubit të Turbinës kapet me pistoletë në Bllok, i del edhe mashtrimi në Vlorë

Tashmë Gjoka do të përballlet me drejtësinë me akuzën e armëmbajtjes pa leje duke rrezikuar 7-15 vite burg, por edhe mashtrimin.

RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com



**Redaksia**

20 Dhjetor 2019, 11:53 | Përditesimi i fundit: 23 Dhjetor 2019, 16:27

Share 62

Tweet

A⁺ A⁻**Nje det me oferta te pret...****zbulo me teper ne booking.adriaferries.com**

TIRANE-Presidenti i ekipit të futbollit të Turbinës së Cërrikut, Gentian Gjoka 45-vjeç me origjinë nga Vlora është arrestuar mbrëmjen e djeshme në zonën e Bllokut, pasi nga kontrolli fizik dhe në banesë iu gjet një armë zjarri pistoletë, me një krehër me fishekë.

Operacioni sipas policisë u bë pas informacioneve nga qytetarë të krahut të Veriut të qarkullonte me armë zjarri. Pas lokalizimit, ai u prangos në rrugën “Medar Shtylla”. Më pas nga verifikimet rezultoi se Gjoka ishte i shpallur në kërkim për llogari të policisë së Vlorës për

RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com

mashttrim. Edhe pse në kërkim ai lëvizte i qetë dhe madje i armatosur në një nga zonat më të frekuentuara në Tiranë.



[Sh]
.com

LEXO EDHE:

OFL zhvendoset në Elbasan/ Kush janë 4 të dënuarit që duhet të deklarojnë pasurinë (EMRAT)

Tashmë Gjoka do të përballet me drejtësinë me akuzën e armëmbajtjes pa leje duke rrezikuar 7-15 vite burg, por edhe mashttrimit. Armëmbajtja pa leje në Kodin Penal ishte me burgim nga tre deri në shtatë vjet, por me ndryshimet në kodin e ri rritja e dënimit u bë nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.



Pistoleta e sekuestruar nga policia



Policia e Shtetit

December 20 at 11:41 AM · 🌐

Tiranë

Finalizohet një tjetër operacion për goditjen e armëmbajtjes dhe kapjen e personave në kërkim.

Operacioni "Lokalizmi". i zhvilluar nga Komisariati i Policisë Nr. 2.

RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com

Kapet një person i shpallur në kërkim, i cili mbante armë zjarri me vete.

Sekuestrohet një armë zjarri pistoletë, me një karikator me fishekë luftarak.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 2, në vijim të punës për kapjen e personave në kërkim dhe të atyre që qarkullojnë me armë zjarri, kanë shtuar kontrollet në gjithë territorin që kanë në juridiksion.

Bazuar në informacionet e marra nga qytetarët se një person në kërkim qarkullonte me armë zjarri, nga shërbimet e Seksionit të Hetimit të Krimeve në Komisariatin e Policisë Nr. 2 Tiranë është organizuar dhe finalizuar operacioni "Lokalizimi", në kuadër të të cilit u bë kapja dhe arrestimi i shtetasit të shpallur në kërkim:

G. Gj., 45 vjeç, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë.

Shërbimet e Policisë kanë bërë të mundur lokalizimin e tij në rrugën "Medar Shtylla" dhe falë ndërhyrjes në kohë është bërë e mundur kapja e tij. Nga kontrolli fizik dhe në banesë këtij shtetasi iu gjet një armë zjarri pistoletë, me një krehër me fishekë luftarak.

Nga verifikimet e bëra rezultoi se shtetasi G. Gj. ishte i shpallur në kërkim për llogari të DVP Vlorë, për veprën penale "Mashtrimi".

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprën penale "Mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe municionit".



Njoftimi i policisë se shtetit